



Pranuar / Dorezuar Pritmjen/Pradato Received/Delivery	05-05-2021	viti god year	2021
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	2208/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.222/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtarë si dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.820/19 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.32/2019 të datës 22.01.2019 të parashtruar nga ankuesi: ne adrese banimi rruga Ismail Qemali, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "masë disiplinore ", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **SHFUQIZOHET** Vendimi me numër protokoli Nr.116-934/8 i datës 24.12.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Vendimi me numër protokoli Nr.116-934 i datës 06.08.2018 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit të datës 15.08.2018.
- II. **OBLIGOHET** Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëj **rishqyrtimin e lëndës** për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit
- III. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, t'i ndërmarrin të gjitha veprimet administrative për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal me datë 19.07.2018 ka paraqitur kërkesën për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit për

shkak të dyshimit të kryerjes së shkeljes së rëndë disiplinore, pasi që ankuesi ka qenë përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë procesit të draftimit të Ligjit për dhënien e pronës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale, ndërkohë që pa paralajmërim për grupin punues dhe Sekretaren e Përgjithshme, e ka fëshir nenin 11 të projektligjit.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, me datë 06.08.2018 ka nxjerr vendim me numër 116-934 më të cilin vendim ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „Largim nga Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave dhe të transferohet në një lokacion tjetër, me detyra të ngjashme”. Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal duke e bërë zbatimin e vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 06.08.2018 bënë ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit, që ankuesin nga pozita “Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave” e transferon në pozitën “Udhëheqës i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave” në kuadër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nga data 15.08.2018.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 06.08.2018 me numër 116-934, me datë 31.08.2018 ka parashtruar ankesën me numër 116-934/3 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal edhe përkundër obligimit ligjorë të përcaktuar me dispozitat e nenit 9 paragrafit 7 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave nuk ka vendosur për ankesën me numër 116-934/3 të datë 31.08.2018 të parashtruar nga ankuesi.

Ankuesi me datë 03.08.2018 përmes emalit zyrtar është njoftuar nga Zyra e Personelit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka marr vendim për ankesën e parashtruar nga ankuesi.

Ankuesi i pakënaqur me mos marrjen e përgjigjes nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal brenda afatit ligjor në pajtim me nenit 16 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me datë 29.10.2018 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 6392/2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 10.12.2018 merr vendimin A.nr.696/2018, me të cilin vendim e detyron Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi ta shqyrtoj ankesën me numër 116-934/3 të datës 31.08.2018 të parashtruar nga ankuesi në këtë komision.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, duke e bërë zbatimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.696/2018 të datës 10.12.2018, merr vendimin me numër 116-934/8 të datës 24.12.2018 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankuesit dhe mbetet në fuqi vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 06.08.2018 me numër 116-934.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e datës 24.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, me

datë 22.01.2019 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me datë 11.03.2019 ankuesi _____ përsërit kërkesën për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 12.03.2019 e njofton ankuesin lidhur me kërkesën e tij të datës 11.03.2019, se Këshilli nuk ka kuorum për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit andaj edhe udhëzon ankuesin së të hap konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë me datë 15.03.2021 merr Aktgjykimin me numër A.nr.820/2019, të cilin Aktgjykim Këshilli e ka pranuar me datë 01.04.2021 me numër të protokollit 1544/21 me të cilin Aktgjykim është aprovuar kërkesëpadia e paditësit _____ edhe është anuluar njoftimi i datës 12.03.2019 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 30.10.2018, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Më datë 06.11.2018 Këshilli ka pranuar përgjigjen në kërkesë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Njoftimin e datës 12.03.2019 për ankuesin; Aktgjykimin A.nr.820/19 i datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën e datës 11.03.2019; Ankesën e datës 22.01.2019 e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 347/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e KZKA-së Nr.116-934/8, të datës 24.12.2018; Vendimin e KPMSHCK-së, Nr. 7531/2018, të datës 10.12.2018; Ankesën e datës 29.10.2018 e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 6392/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 06.08.2018 me numër protokollit 116-934; Ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MAPL nr.116-934/3 të datës 31.08.2018; Emali zyrtar i datës 19.07.2018; Emali zyrtar i datës 03.10.2018; Emali zyrtar i datës 02.10.2018; Kërkesa e datës 08.08.2018; Emali zyrtar i datës 06.08.2018; Shkresë e datës 10.08.2018; Emali zyrtar i datës 28.08.2018; Ndryshim plotësimi i akt emërimit i datës 15.08.2018; Emali zyrtar i datës 29.08.2018; Vendimi i datës 16.08.2018; Emali zyrtar i datës 27.08.2018; Vendimi i datës 20.03.2018 për formimin e Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 28.03.2018 për formimin e Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 24.07.2018 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr.116-378; Emali zyrtar i datës 25.07.2018; Ftes e datës 09.07.2018; Emali zyrtar i datës 23.07.2018; Procesverbal i datës 25.07.2018; Procesverbal i datës 31.07.2018; Shkresë e datës 23.07.2018; Emali zyrtar i datës 20.06.2018; Vendimi i datës 07.02.2018; Vendimi i datës 16.03.2018; Shkresë e datës 22.06.2018; Emali zyrtar i datës 27.04.2018; Shkresë e datës 27.04.2018; Emali zyrtar i datës 11.06.2018; Emali zyrtar i datës 28.08.2018; Emali zyrtar i datës 18.07.2018; Kërkesa për përgjigje e datës 30.10.2018; Përgjigja në kërkesë e datës 06.11.2018; Emali zyrtar i datës 19.07.2018; Emali zyrtar i datës 18.07.2018; Emali zyrtar i datës 17.07.2018; Emali zyrtar i datës 23.07.2018; Ndryshim plotësimi i akt emërimit për _____ i datës 21.12.2017; Diploma e _____ Ndryshim plotësimi i akt emërimit për _____ i datës _____ Ndryshim plotësimi i akt emërimit për _____ Diploma e Nikola Aksic; Ndryshim plotësimi i akt emërimit për _____

datës 15.08.2018; Ndryshim plotësimi i akt emërimit për i
datës 14.03.2018; Emali zyrtar i datës 01.08.2018; Emali zyrtar i datës 09.08.2018 dhe Emali zyrtar
i datës 08.08.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat
e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ekziston baza ligjore që ankesa e ankuesit
ë kthehet në **rishqyrtim**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së
Administrimit të Pushtetit Lokal ka nxjerr Vendim me numër prtokolli 116-934 të datës
06.08.2018, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore " *Largim nga Departamenti Ligjor
dhe Monitorim të Komunave dhe të transferohet në një lokacion tjetër, me detyra të ngjashme*"..

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor masën e ka shqiptuar
në kundërshtim me nenin 67 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 pikën 1.2.3, të Ligjit Nr. 03/L-149
për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse Komisioni Disiplinor ka dështuar që të
shqiptoj saktw dhe tw plotë masen disiplinore, respektivisht e ka ndarw masen disiplinore pasi
qw nuk e ka shqiptuar edhe *ndalimin e gradimit si dhe afatin e saktë të kohezgjatjes të ndalimit
tw gradimit*, e që është në kundërshtim me dispozitën e ligjit.

Me dispozitat e nenit 67 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kjo
masë disiplinore është përcaktuar si në vijim *„largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion
tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni
disiplinor; duke e lënë në diskrecionin e komisionit disiplinor që në varësi të shkeljes dhe
provave të bashkëngjitura të shqiptoj masen e plotw pa e ndare dhe të përcaktoj saktë periudhën
e masës disiplinore brenda afatit maksimal prej 5 viteve, ndersa caktimi se në cilën pozitë
transferohet nëpunësi të cilit i jepet kjo masë, është kompetencë e zyrtarit kryesor administrativ.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar dosjen e lëndës, ka konstatuar se masa e
shqiptuar nga Komisioni Disiplinor nuk është shqiptuar në pajtim me dispozitat e legjislacionit
për shërbimin civil.

Komisioni Disiplinor me rastin e **rishqyrtimit** të lëndës, është i obliguar që të vlerësoj të gjitha
provat e bashkëngjitura të lëndës, dhe duke marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese
për ankuesin të vendos për shqyrtimin e masës disiplinore, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.
03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij
ligji.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe
të Ankesave në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me rastin e vendosjes së ankesës
me numër protokoli 116-934/3 të datës 31.08.2018 të parashtruar nga ankuesi
është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të
Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si
dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, pasi që ka
dështuar të eliminoj shkeljet e kryera me rastin e nxjerrjes së vendimit nga Komisioni Disiplinor
i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Kolegji për shqyrtim dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër Nr. Nr.116-934/8 i datës 24.12.2018, është nxjerr në kundërshtim me nenin 47 dhe 135 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse vendimit i mungon këshilla juridike dhe po ashtu Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e vendosjes lidhur me ankesën e ankuesit nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, me ç`rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 47 dhe 135 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht nga kjo Kolegji ka vendosur për shfuqizimin e Vendimi t Nr.116-934/8 të datës 24.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin A.nr.820/19 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda A.nr.222/2021

Hysni Mustafa

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Arkivit të KPMSHCK-së.